



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 10.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.09.2024 me titull **LOT 1- Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge (Rr.Shaqir Demaj)** Nr. të Prok: 635-24-8403-5-2-1 dhe nr i brendeshen 635-24-050-5-2-1 nxjerr:

V E N D I M

E- pranuar – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik **BK - CONSTRUCTION SH.P.K..** të datë 09.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **LOT 1-Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge** Nr. të Prok: 635-24-8403-5-2-1 dhe nr i brendeshen 635-24-050-5-2-1 nxjerr: kundër **B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK**, të datës 03.09.2024 të publikuar në platformën elektronike të E- Prokurimit .

ANULOHET vendimi i A.K mbi **B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK PER LOT 1** të publikuar me datë: 03.09.2024

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **BK - CONSTRUCTION SH.P.K..** me datën 09.09.2024 , ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: **LOT 1-Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge** **LOT 2- Ndertimi i ndricimit publik nga rrethi Vitomirice deri te shkolla (Rr.Hasan Muratagic)** dhe ndricimi në fshatrat **Kotradiq, Kristal (Lagja e Bujupt)** dhe **Radac (Rr.Shaqir Demaj)** me Nr. të Prok: 635-24-8403-5-2-1 nr i 635-24-050-5-2-1 nxjerr:

Autoriteti Kontraktues , me datën 10.09.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizës së kërkesës së juaj për **Ri-shqyrtim** duke marrë për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 09.09.2024 , e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur në përfundim se njejtë është **bazuar për LOT 1** ,

Pretendimet e O,E 1

Me datën 09.09.2024 parashtrojm këtë kërkesë për rishqyrtim të vendimit të marrë me datën 03.09.2024. duke respektuar kështu afatet kohorë të lejuara për parashtrimin e kërkesave për rishqyrtim sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Në vazhdim japim detajet me pakënaqësit tona, të cilat i kemi evidentuar gjatë kontrollimit të dokumentacionit të OE të shpallur fitues. Pas kërkesës për qasje në dokumenta të dt 04.09.2024.

Ne nuk pajtojmë me vendimin për dhënie të kontratës të datës 03.09.2024. pasi që është favorizuar një OE i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara sipas FTD. Duke na shtyer kështu të gjykojmë që ju si AK në këtë rast nuk keni vepruar drejt dhe konform LPP-së, duke respektuar në tërësi nenin 59

Fillimisht OE të cilin keni shpallur fitues ka ofertuar me një qmim provokativ konkurrues. I cili qmim mund të shkaktoj probleme ekonomike në të ardhmën. Njëra ndër to është prishja e qmimit të tregut. Duke e ditur që ne jemi duke shkuar drejt normalizimit të punëve dhe ekonomisë vendore dhe atë të shtetit, nuk duhet të lejojmë që të abuzohet në këtë mënyrë me qmime. Kushti për vlerësim ishte Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët]; , por jo nuk nënkupton deri në atë masë që të afekt negative në të ardhmen në qmim të tregut.

Shohim që ky grup I OE ka një diferencë në mes të OE të dytë prej 13,285/eurove. Shumë e cila nuk është e vogël, pasi të tjerët nuk e kanë të njejtën diferencë.

Gjithëashtu ky qmimi I ofruar mund të ndigjoj në cilësinë e dobët, uljen e rrogave të punëtorëve, uljen e kontributeve tatimore. Dëmë I cili nuk do të ket afekt vetëm tek ne si OE por edhe tek Shteti në përgjithësi. Kjo nuk është e tëra ky Grup I OE, ka fertuar me një dosje që kishte edhe mangësi në Dokumentacion Ky grup i OE ka ngarkuar dokumentacionin e mangët sipas kësaj kërkesë. Fillimisht

vendimet për caktimin e menaxherit dhe udhëheqësit nuk janë asnjëra të noterizuar. Edhe pse kjo ka qenë kriter në DT. SHIHE NE DESHMI TE PARAQITUR NE KERKESEN E VULOSUR

Kontratat në mes të kompanisë dhe inxhinierëve Enver Ahmeti, Ilir Meleqi, Halim Bajramaj, Sami Ahmeti-janë të panoterizuara. Kurëse në DT kriteri ka qenë të jenë të noterizuara në prani të noterit të dy palët.

Cv që është kërkuar të jetë e nënshkruar nga ing, ing Sami Ahmeti nuk kishte CV të nënshkruar. Ndërkaq ing Ilir Meleqi sipas referencës të lëshuar nga BM Group është në mardhënie punë që nga viti 2020, por në CV të këtij ing nuk figuron asgjë për këtë bahskëpunim.

Sa I përket diplomës të noterizuar nga ana e ing Sami Ahmeti. Kjo diplomë është noterizuar në vitin 2012. Që bie ndesh me nenin 42 të ligjit UA 05/2022. Dhe nuk mund të konsiderohet valid ky noterizim.

Pergjegjia nga A,K 1,

Ju njoftojm se ne si A,K , kemi shqyrtuar pretendimet e juaja ankimore me kujdes per AP LOT 1- Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge , dhe pretendimet e juaja ne kete pike jane te bazuara dhe ju njoftojm se ne si Autoritet Kontraktues do veproje konform LPP-se dhe rregullave ku lenden per AP LOT 1 do kthehet ne RI-VLERSIM duke u mbeshtetur ne pretendimet ankimore

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato qe u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Me respekt
Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit KK Peje



Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.